

Tahiraj. Kësaj radhe ata e rrëmbyen vajzën e dytë të Igballes, Melihatën. Pesë ditë më vonë, vëllezërit e Melihatës e kanë gjetur trupin e saj në një pyll ndërmjet Ratishtit të Ulët/Donji Ratiš dhe Bardhaniqi/Bardonić. E kishte një plagë nga plumbi dhe ishte e therur në fytyrë. Melihatën e varrosën afro 100 metra larg shtëpisë së familjes Tahiraj. Mbetjet mortore të Igballes dhe Sebahates u gjetën në varrezat e fshatit Piskotë/Piskote [Gjakovë/Dakovica] pas përfundimit të luftës. Ishin në mesin e kufomave që në muajin shtator të vitit 1998 u nxorën nga **Liqeni i Radoniqit/Radoničko jezero**, por nuk u identifikuan. Mbetjet mortore të Igballes iu dorëzuan familjes më 19.08.2006, ndërkaq ato të Sebahates më 23.08.2007. U varrosën në pronë familjare.

**Burimet:** deklarata R.G, FDH-29918; OMPE, *Mbetjet...*, FDH-15297.

### **Lush (Mahmut) Binakaj**

(8.09.1912, shqiptar nga Carrabregu i Ulët/Donji Crnobreg, komuna e Deçanit/Deçani, i pamartuar, bujk)

Lushi i moshëthyer jetonte në bashkësi familjare me djalin e vëllait, Ismetin, dhe familjen e tij në Carrabregun e Ulët/Donji Crnobreg. Kur forcat serbe depërtuan në fshat me tanket, më 31.05.1998, Lushi dhe Ismeti me të gjithë familjarët kaluan në Beleg, ku i ka strehuar kushëriri Ramush Vishaj. Të nesërmen, më **1.06.1998**, Lushi ka dal nga shtëpia duke u thënë familjarëve se po shkonte në **Carrabregun e Ulët/Donji Crnobreg**. Nga ajo ditë, atij i ishte humbur çdo gjurmë. Ismeti e ka kërkuar Lushin në Carrabregun e Ulët/Donji Crnobreg, por askush nuk ishte në gjendje t'i thoshte asgjë për axhën e tij. Zhdukja e Lushit është e regjistruar nga KNKK-ja dhe lënda e tij në regjistrin e të zhdukurve e mban numrin rendor BLG-803715-01.

**Burimet:** deklarata H.Z, FDH-17888; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

### **Bajram (Selmon) Ramosaj**

(1925, shqiptar nga Carrabregu i Ulët/Donji Crnobreg, komuna e Deçanit/Deçani, tregtar, gjashtë fëmijë)

Bajrami me familje jetonin në Carrabregun e Ulët/Donji Crnobreg. Kur forcat serbe e sulmuan **Carrabregun e Ulët/Donji Crnobreg** më **1.06.1998**, ai ishte vetëm në shtëpi ngase familjarët e tij e kishin braktisur fshatin më herët. E kishin vrarë në oborrin e shtëpisë së tij. Banorët e fshatit e kanë varrosur Bajramin vetëm pas tri javësh, më 21.06.1998, në livadhin e familjes Ramosaj. Familjarët i kanë rivarrosur mbetjet e tij mortore në varrezat e Carrabregut të Ulët/Donji Crnobreg, në vitin 2000.

**Burimet:** deklarata Sh.G, FDH-18728; deklarata Z.Z., FDH-12056; deklarata S.D, FDH-12203.

### **Mone (Haxhi Kadrijaj) Balaj**

(5.10.1929, shqiptar nga Carrabregu i Epërm/Gornji Crnobreg, komuna e Deçanit/Deçani, amvise, shtatë fëmijë)

Mone Balaj ka mbetur vetëm në **Carrabregun e Epërm/Gornji Crnobreg**, kur familjarët e saj e braktisën fshatin për shkak të granatimeve të pandërprera nga ana e forcave serbe [29.05.1998]. Sipas rrëfimit të të rejës së Mones, djali i Mones, Agimi, u kthye në fshat më **1.06.1998**, për ta tërhequr të ëmën. Përderisa i afrohej shtëpisë, e kishte vërejtur Monen duke i pastruar enët në çezmën përpara shtëpisë. Në ato çaste, një veturë e blinduar hyri në oborr, duke e rrënuar kapinë. Përderisa ikte me vrap, Agimi dëgjoi të shtëna rafali që vinin nga oborri i shtëpisë. Të afërmit, të cilët u kthyen në fshat në muajin nëntor të vitit 1998, i kanë gjetur mbetjet e karbonizuara mortore të Mones, si dhe një palë vathë dhe disa pjesë të rrobave të saj. Mbetjet mortore të Mones i kanë varrosur në varrezat lokale.

**Burimet:** deklarata S.B, FDH-17907; deklarata I.H, FDH-17901.

### **Ramadan (Maxhun) Dautaj**

(16.03.1941, shqiptar nga Carrabregu i Epërm/Gornji Crnobreg, komuna e Deçanit/Deçani, profesor i gjeografisë, tetë fëmijë)

Ramadani ka mbetur me tre djemtë e tij në shtëpi [**Carrabregu i Epërm/Gornji Crnobreg**] deri më 31.05.1998, kur të gjithë